



Primitur / Received Prenjuro / Protocolado Received / Delivered	18.08.2022	2	viti god year
Organ / Organi Organ / Organi Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHK	4787/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KESHILLI I PAVARUR MBIKEQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.592/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arditë Haxhnikaj-Demi- kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.592/2022 të datës 05.07.2022, të parashtruar nga ankuesi _____ nga _____ kundër heshtjes administrative të Komunës së Kamenicës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës-cenim i së drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 17.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.592/2022 e datës 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi _____
- II. *Obligohet* Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Kamenicës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për kompensimin e pagës së ankuesit sipas koeficientit të pagës të përcaktuar me Ndryshim dhe Plotësim të Akt-it të Emërimit me numër protokoli 02-613 të datës 09.01.2014, duke filluar nga data e parashtrimit të kërkesës me numër protokoli 02-16791 të datës 31.05.2022.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Komunën e Kamenicës, në pozitën “*Udhëheqës i Zyrës Ligjore*”, më datë 05.07.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3899/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Komunës së Kamenicës, për shkak të heshtjes administrative lidhur me moszbatimin e Ndryshim dhe Plotësimit të Akt-it të Emërimit me numër protokoli 02-613 të datës 09.01.2014, si dhe Vendimit me numër protokoli 02-23903 të datës 03.08.2015 të Komisionit Komunal për Zgjedhjen e Kontesteve dhe ankesave dhe Vendimit me numër protokoli 02-23331 të datës 11.08.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Kamenicës. Ndërsa Këshilli, me datë 27.07.2022 ka pranuar provat lidhur me këtë çështje ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3899/2022 të datës 05.07.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër protokoll 02/16791 të datës 31.05.2022; Ndryshimi dhe Plotësimi i akt emërimit me numër protokollit 02/613 të datës 09.01.2014; Vendimin me numër protokollit 02/23903 të datës 03.08.2015 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin me numër protokollit 02-23331 të datës 11.08.2021 të Kryetarit të Komunës së Kamenicës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 4076/2022 të datës 13.07.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 4342/2022 të datës 27.07.2022; Kërkesën me numër protokollit 02-17511 të datës 28.08.2021; Emalin e datës 05.08.2022 me numër të protokollit 4567/2022 të Njësisë së Burimeve Njerëzore drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës lidhur me prova shtesë të lëndës; Akt emërimit me numër protokollit 02-540/56 të datës 15.09.2011 të nëpunësit civil Ndryshim dhe plotësimin e akt emërimit me numër protokollit 02/ 8118 të datës 03.09.2015; Akt emërimit me numër protokollit 02/538/64 të datës 15.09.2011 të nëpunësit civil M.TH; Konfirmimin për disponueshmërinë e mjeteve me numër 02-28755 të datës 22.09.2021; Akt emërimit me numër protokollit 02/25142 të datës 05.06.2017 të nëpunësit civil Akt emërimit me numër protokollit 02/37811 të datës 08.09.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës një nga një dhe të gjitha së bashku, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e bazuar, SEPSE:*

Nga administrimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Akt-it të Emërimit të datës 15.09.2011, rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Komunën e Kamenicës në pozitën "Përgjegjës i Sektorit/Zyrës Ligjore", me koeficient tetë (8) të pagës. Të njëjtit me datën 09.01.2014 i është bërë ndryshim dhe plotësimi i Akt-it të Emërimit mbi bazën e nivelizimit të koeficientit të pagës me zyrtaret e njëjtë të komunave tjera, nga tetë (8) në koeficientin nëntë pikë pesë (9.5).

Me tej nga shkresat e lëndës, Kolegji gjen se ankuesi me datë 30.07.2015, për shkak të mos realizimit të pagës sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt-it të Emërimit të datës 09.01.2014, i është drejtuar me ankesë Komisionit Komunal për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Kamenicës, ndërsa ky i fundit më datë 03.08.2015 me Vendimin me numër protokollit 02-23903 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar Zyrën e Personelit që të ndërmerr të gjitha veprimet për zbatimin e Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt-it të Emërimit të datës 09.01.2014.

Ankuesi serish me datë 28.06.2021 parashtron kërkesë për zbatimin e Ndryshim dhe Plotësim të Akt-it të Emërimit të datës 09.01.2014, me ç'rast Kryetari i Komunës me vendimin me numër protokollit 02-2331 të datës 11.08.2021 ka obliguar Zyrën e Personelit dhe Departamentin e Financave që të bëjnë llogaritjen e pagës dhe pagesën në mënyrë retroaktive prej 8 në 9.5 të koeficientit të pagës sipas Ndryshim dhe Plotësim të Akt-it të Emërimit të datës 09.01.2014.

Ankuesi me datë 31.05.2022 parashtron kërkesë pranë organit të punësimit gjegjësisht Kryetarit të Komunës për zbatimin e Ndryshim dhe Plotësim të Akt-it të Emërimit të datës 09.01.2014. Për shkak

të heshtjes së vazhdueshme të organit të punësimit, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin që Këshilli ta aprovoj ankesën dhe të obligoj Kryetarin e Komunës së Kamenicës që ti zbatoj vendimet dhe aktin e emërimit lidhur me nivelizimin e pagës ashtu siç e kanë edhe shefat e sektorëve tjerë brenda komunës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës Kolegji gjen së Udhëheqësi i Sektorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Kamenicës, më datë 22.09.2021 përmes shkresës me numër protokollit 02-28755, ka kërkuar ekzekutimin e nivelizimit të koeficientit të ankuesit në Ministrinë e Financave-Thesarin e Kosovës, pasi që Komuna e Kamenicës ka buxhet të mjaftueshëm për pagesë, mirëpo nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet së Thesari i Kosovës të ketë ekzekutuar ketë kërkesë rrjedhimisht ankuesit nuk i është njohur e drejta e realizmit të pagës sipas koeficientit të vendosur me Ndryshim dhe Plotësim të Akt-it të Emërimit të datës 09.01.2014.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 19 ku theksohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërlidhur me këtë neni 3 i Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ka përcaktuar se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civilë të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës ju garantohet dhe duhet të realizojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë.

Kolegji i Këshillit për vendosje meritore të kësaj çështje juridike ka analizuar edhe nenin 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë me të cilin është përcaktuar se: *1.Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat....*andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si më lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji gjen së organi i punësimit në këtë rast Komuna e Kamenicës ka ndërmarr të veprimet nevojshme për harmonizimin e koeficientit të ankuesit gjegjësisht janë nxjerr aktet administrative me të cilat ankueset i është njohur e drejta e nivelizimit të pagës, janë planifikuar mjete buxhetore si dhe është bërë kërkesë në ministrinë përgjegjëse për ekzekutimin e aktit për nivelizimin e koeficientit të pagës, mirëpo që kjo e fundit nuk ka ekzekutuar kërkesën në fjalë, andaj mbi bazën e kësaj gjendje faktike, Kolegji me të drejtë vlerëson së ankuesi në kuptim të realizmit të së drejtës së pagës vazhdon të trajtohet në mënyrë me pak të favorshme se sa nëpunësit civilë të cilët ushtrojnë pozitë të kategorisë së njëjtë të punës brenda vet institucionit punëdhënës. Ne këtë kontest, nga provat materiale lidhur me çështjen është konstatuar se nëpunësi civil S.Kastrati në pozitën e punës "Menaxher i Sektorit të Projekteve", realizon koeficient 9.5 të pagës sipas Akt-it të Emërimit me numër të protokollit 02-540/56 të datës 15.09.2011, nëpunësi Civil

në pozitën e "Udhëheqësit të Sektorit të Planifikimit, realizon koeficient 9.5 të pagës sipas Akt-it të Emërimit me numër të protokollit 02-538/64 të datës 15.09.201, nëpunësi civil E.Kastrati në pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit-Zyrës së Prokurimit", realizon koeficient 9.5 të pagës sipas Akt-it të Emërimit me numër të protokollit 02- 25142 të datës 05.06.2017, si dhe nëpunësi civil

në pozitën e punës “ Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa ”, realizon koeficient 9.5 të pagës sipas Akt-it të Emërimit me numër të protokollit 02 02-37811 të datës 08.09.2017, rrjedhimisht nisur nga ekzistimi i ketyre fakteve rezulton së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit brenda të njëjtit institucion dhe një veprim/mosveprim i tillë i organit të punësimit është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 ku përcaktohet se “Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.

Për me tepër bazuar në gjendjen faktike si me lartë, Kolegji vlerëson së mos kompensimi i pagës së ankuesit sipas aktit për nevillezim të koeficientit të pagës bie ndesh edhe me parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë konkretisht nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është theksuar se : *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë, e mbi këto arsye, Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara dhe të ligjshme.*

Andaj, bazuar në rrethanat si me lartë, obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Kamenicës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për kompensimin e pagës së ankuesit sipas koeficientit të pagës të përcaktuar me Ndryshim dhe Plotësim të Akt-it të Emërimit me numër protokollit 02/613 të datës 09.01.2014, duke filluar nga data e parashtrimit të kërkesës me numër protokollit 02/16791 të datës 31.05.2022.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.592/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.